

Njoftim
Për mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve

Shoqëria NOA sh.a ju bën me dije se mbledhja e parë e zotëruesve të obligacioneve do të organizohet më datë 07.11.2023, ora 11:00, në Rogner Hotel Tirana adresën Bulevardi Dëshmorët e Kombit • Postal Code 1001 • AL-Tirana.

Rendi i mbledhjes do të jetë:

1. Zgjedhja e përfaqësuesit të zotëruesve të obligacioneve:

Zotëruesit e obligacioneve kanë të drejtën e zgjedhjes së një përfaqësuesi, i cili do të jetë përgjegjës për përfaqësimin e interesave të tyre dhe duhet të zgjedhet në mbledhjen e datës 07.11.2023. Në çdo rast përfaqësimi miratohet nga zotëruesit e obligacioneve sipas Formularit të Përfaqësimit në Letër bashkëngjitur.

Pas zhvillimit të mbledhjes së parë të zotëruesve të obligacioneve, mbledhjet vijuese do të njoftohen dhe zhvillohen nëpërmjet përfaqësuesit sipas rregullores dhe rendit të njoftuar dhe përcaktuar prej tij.

2. Miratimi i përdorimit të mjeteve të komunikimit nga zotëruesit e obligacioneve:

Në mbledhje pritet të diskutohet dhe miratohet gjithashtu përdorimi i mjeteve elektronike, rregullave të identifikimit për qëllime të përcjelljes së informacionit nga shoqëria NOA sh.a tek zotëruesit e obligacioneve sipas Formularit bashkëngjitur, si dhe diskutimi dhe miratimi i çështjeve të tjera të ngritura gjatë mbledhjes;

3. Paguesa e interesit dhe të drejtat që rrjedhin nga titulli

4. Çështje të tjera të propozuara gjatë mbledhjes.

- Formulari i Përfaqësimit në Letër

Zotëruesit e obligacioneve me të drejtë vote në mbledhjen e zotëruesve të obligacioneve kanë të drejtën e përfaqësimit. Përfaqësuesi i zgjedhur mbron interesat e zotëruesve të obligacioneve. Përfaqësimi miratohet nga zotëruesi i obligacioneve sipas Formularit të Përfaqësimit në Letër bashkëngjitur.

FORMULAR

I Përfaqësimit në Letër

A. Informacion i Përgjithshëm mbi Obligacionmbajtësin			
Emër Mbimemër:			
Atësi:			
Amësi:			
Datëlindje:			
Vendlindje:			
Shtetësi:			
Dokument Identifikimi:			
Nr Dokumenti:			
Nr Personal:			
Vlera e Obligacioneve të zotëruara:			
Numri i Obligacioneve të zotëruara:			
B. Informacion i Përgjithshëm mbi Përfaqësuesin			
Përfaqësues Person Juridik		Përfaqësues Individ	
Emri i Shoqërisë		Emër Mbimemër	
NUIS		Atësi	
Nr dhe data e Licencës nga AMF		Amësi	
Objekti i Veprimtarisë		Datëlindje	
Kapitali i Regjistruar		Vendlindje	
Përfaqësues Ligjor/Administrator		Shtetësi	
Adresa e Selisë		Dokument Identifikimi	
Faqja e Internetit		Nr Dokumenti	
Posta Elektronike		Nr Personal	
		Posta Elektronike	
C. Tagrat e Përfaqësimit			
1. Përfaqësuesi njofton, thërret dhe organizon mbledhjet e obligacionmbajtësve sipas modaliteteve të përcaktuara dhe në përputhje me vendimarrjet e obligacionmbajtësve.			
2. Përfaqësuesi zbaton në kohë të gjitha vendimet e marra në mbledhjet e obligacionmbajtësve.			
3. Përfaqësuesi përfaqëson obligacionmbajtësit në gjykata dhe institucione të tjera, përballë Emetuesit dhe/ose palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre.			
4. Përfaqësuesi informohet në mënyrë të vazhdueshme mbi Emetuesin, performancën e tij në biznes, situatën e tij financiare, gjendjen e tij gjyqësore etj dhe informon menjëherë obligacionmbajtësit mbi informacione, të dhëna apo situata të cilat çënojnë ose mund të çënojnë interesat ose të drejtat e obligacionmbajtësve.			

5. Përfaqësuesi verifikon përmbushjen e të gjitha detyrimeve të Emetuesit ndaj obligacionmbajtësve dhe e kontakton menjëherë Emetuesin në rast se konstatohet ndonjë vonesë apo problematikë tjetër lidhur me shlyerjen e detyrimeve të tij. Përfaqësuesi njofton menjëherë obligacionmbajtësit mbi komunikimin me Emetuesin dhe therrët mbledhjen e obligacionmbajtësve për të marrë vendime për adresimin e problematikave.

6. Përfaqësuesi merr pjesë në mbledhjet e organeve drejtuese të Emetuesit në rastet kur në rend të ditës së këtyre mbledhjeve trajtohen çështje që prekin ose mund të prekin interesat ose të drejtat e obligacionmbajtësve.

7. Përfaqësuesi, përpara thirrjes së çdo mbledhje të obligacionmbajtësve, i kërkon Emetuesit dhe/ose Regjistrarit ALREG listën e përditësuar të zotëruesve të obligacioneve të NOA-s në mënyrë që të njoftojë obligacionmbajtësit mbi mbledhjen.

8. Përfaqësuesi, në rast të një numri të madh të zotëruesve të obligacionmbajtësve (mbi 200 investitorë), dhe nëse është vendosur kështu në mbledhjen e parë të obligacionmbajtësve, shpall njoftimet për mbledhjet e obligacionmbajtësve në faqën e tij të internetit.

9. Përfaqësuesi i kërkon Emetuesit çdo informacion që gjykon të nevojshëm për të vlerësuar situatën e tij financiare dhe ligjore.

10. Përfaqësuesi kryen çdo detyrë tjetër sic mund të përcaktohet nga vendimet e obligacionmbajtësve, gjithnjë nëse këto detyra ato nuk janë në konflikt me ndonjë dispozitë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Emër Mbiemër Firmë

Datë

Përfaqësuesi i zotëruesve të obligacioneve përfaqëson interesat e këtyre të fundit. Në çdo rast, Zotëruesit e obligacionve nga ana e tyre kanë të drejtë të miratojnë edhe vetë Përfaqësuesin e tyre duke nënshkruar Formularin e Përfaqësimit në Letër të publikuar në website të NOA sh.a.

FORMULAR

Miratimi i Përdorimit të Mjeteve Elektronike dhe Rregullave të Identifikimit

A. Informacion i Përgjithshëm mbi Obligacionmbajtësin	
Emër Mbimemër:	
Atësi:	
Amësi:	
Datëlindje:	
Vendlindje:	
Shtetësi:	
Dokument Identifikimi:	
Nr Dokumenti:	
Nr Personal:	
Vlera e Obligacioneve të zotëruara:	
Numri i Obligacioneve të zotëruara:	
B.Mjetet Elektronike të Miratuara për Përcjelljen e Informacionit	
Website i NOA:	
Posta elektronike-email:	
Mesazhe telefonike në numrin:	
Mjete të tjera të qëndrueshme (përcakto):	
Me nëshkrimin e këtij formulari jap miratimin tim për përdorimin e një prej mjeteve elektronike të përcaktuara më lart të përcjelljes së informacionit nga NOA sh.a.	
<i>* Shënim: Miratimi i përdorimit të mjeteve elektronike përcaktuar më lart do të konsiderohet i dhënë nëse nuk paraqitet kundërshtim brenda një afati prej 10 ditësh nga data e fitimit të cilësisë si zotërues i obligacioneve dhe me kushtin që ky formular të jetë publikuar në website të NOA. Zotëruesi i obligacioneve ka mundësi të kërkojë në çdo kohë në të ardhmen që informacioni të përcillet me shkrim.</i>	

Mbiemër Firmë

Date
